

Shtojca 1: Termat e Referencës / Përshkrimi i shërbimit

Titulli i programit:	KCSF
Titulli i kontratës:	Shërbime të përkthimit

HYRJE

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) është organizatë e pavarur, jofitimprurëse, që vazhdimisht angazhohet në krijimin dhe zhvillimin e një shoqërie demokratike dhe pjesëmarrëse në Kosovë. Përgjatë më shumë se 25 viteve, KCSF ka kontribuar në promovimin e politikëbërjes së bazuar në dëshmi, zgjerimin e hapësirës qytetare dhe mbështetjen e mbi 750 nismave qytetare me një investim të konsiderueshëm prej mbi 30 milionë euro, ngritjen e njohurive dhe shkathtësive të mijëra aktivistëve/eve të shoqërisë civile në Kosovë dhe në Ballkanin Perëndimor përmes më shumë se 1,100 sesioneve trajnuese.

SPECIFIKAT E SHËRBIMIT

Me qëllim që të mundësohet komunikimi dhe informimi i drejtë dhe i saktë, pa u humbur kuptimi origjinal për individ, grupe ose organizata nga kultura dhe gjuhë të ndryshme, KCSF kërkon shërbime të përkthimit tekstual, simultant dhe konsektiv, nga operatorë ekonomik që janë të regjistruar si kompani profesionale të përkthimit dhe zotërojnë kapacitete për ofrimin e shërbimeve të përkthimit në gjuhë Shqipe, Angleze dhe Serbe.

Ftesa për Kuotim të çmimit është e ndarë me lote. Për ofrimin e shërbimeve të përkthimeve tekstuale specifikat janë të vendosura në LOT 1, ndërsa për ofrimin e shërbimeve të përkthimeve simultante dhe konsektive, specifikat janë të vendosura në LOT 2.

Ofertuesit mund të ofertojnë në të dy lotet në një aplikim të vetëm, ose vetëm në njërin nga lotet e kësaj ftese.

LOT 1

Përkthim dhe lekturim tekstual i materialeve të ndryshme (word, excel, powerpoint, fletushka, etj) nga gjuha shqipe në gjuhën angleze dhe anasjelltas;

Përkthim dhe lekturim tekstual i materialeve të ndryshme (word, excel, powerpoint, fletushka, etj) nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe anasjelltas;

Përkthim dhe lekturim tekstual i materialeve (word, excel, powerpoint, fletushka, etj) nga gjuha angleze në gjuhën serbe dhe anasjelltas;

Lekturim tekstual i materialeve (word, excel, powerpoint, fletushka, etj) në gjuhë shqipe;

Lekturim tekstual i materialeve (word, excel, powerpoint, fletushka, etj) në gjuhë serbe;

Lekturim tekstual i materialeve (word, excel, powerpoint, fletushka, etj) në gjuhë angleze;

LOT 2

Përkthim simultan nga gjuha shqipe në gjuhë serbe dhe anasjelltas;
Përkthim simultan nga gjuha shqipe në gjuhë angleze dhe anasjelltas;
Përkthim simultan nga gjuha angleze në gjuhë serbe dhe anasjelltas;
Përkthim konsektiv nga gjuha shqipe në gjuhë serbe dhe anasjelltas;
Përkthim konsektiv nga gjuha shqipe në gjuhë angleze dhe anasjelltas;
Përkthim konsektiv nga gjuha angleze në gjuhë serbe dhe anasjelltas;

FUSHËVEPRIMI I SHËRBIMIT

Qëllimi i kësaj ftese për koutim të çmimit është sigurimi i shërbimeve të përkthimit sipas kërkesave të KCSF-së nga kompani profesionale të përkthimeve.

Kohëzgjatja e shërbimeve të përkthimit planifikohet për periudhë 2 vjeçare, me mundësi vazhdimi edhe për 1 vit shtesë.

KCSF synon që për këto shërbime të kontrakttoj së paku dy kompani profesionale të përkthimeve, pa të drejta ekskluzive për ndonjërin prej tyre.

Kontraktimi me kompanitë profesionale të përkthimit, kërkon cilësi dhe profesionalizëm për të gjitha llojet e përkthimeve sipas kësaj ftese. Përveç respektimit të afateve të ngjeshura, parashikohen dhe dispozita specifike mbi nivelin e cilësisë së pranueshme gjatë zbatimit të kontratës si:

- 1 deri në 2 gabime për faqe: tolerohet
- 3 deri në 4 gabime për faqe: sanksionohet me 50% të pagesës për faqe, (në raste të përsëritura paraqet bazë për shkëputje të kontratës)
- 5 e më shumë gabime për faqe, shërbimi nuk paguhet (në raste të përsëritura paraqet bazë për shkëputje të kontratës)

Për secilin përkthim, pavarësisht vëllimit dhe afatit, kërkohet siguri për saktësi dhe përshtatje, pa u humbur kuptimi origjinal i mesazhit, raportit dhe komunikimit në përgjithësi.

KËRKESAT PËR KUALIFIKIM

Kompania duhet të ketë së paku 3 vite përvojë të dëshmuar në fushën e shërbimeve të përkthimit, me theks në përvojë me organizata jo qeveritare.

Krahas përvojës së dëshmuar, nevojitet personeli i kualifikuar, i cili zotëron njohuri dhe përvojë në fushën e përkthimeve. Preferohet ekip me eksperiencë pune prej jo më pak se tre vite në përkthim, që zotërojnë mirë programet bazë të kompjuterit, që kanë studiuar ose e njohin shumë mirë gjuhën të cilën e përkthejnë.

Deklarata nën Betim nga Personi Juridik/Fizik dhe Parandalimi i Konfliktit të Interesit

Të gjithë ofertuesit duhet të paraqesin Deklaratën nën betim për kriteret e përjashtimit dhe parandalimit të konfliktit të interesit (shih Shtojcën 2), të nënshkruar nga përfaqësues i autorizuar i kompanisë duke cekur datën, duke deklaruar se ata nuk janë në një nga situatat e përjashtimit të renditura në Shtojcën 2.

Propozimi Teknik

Propozimi teknik duhet të mbulojë të gjitha elementet e kërkuara në specifikimin teknik dhe të sigurojë të gjithë informacionet e nevojshme për të zbatuar kriteret e dhënies së kontratës. Ofertat që devijojnë nga kërkesat ose nuk mbulojnë të gjitha kërkesat mund të refuzohen në bazë të mosrespektimit të specifikimeve të tenderit.

Propozimi Financiar

Çmimi në propozimin financiar duhet të kuotohet në euro. Çmimet duhet të kuotohen pa përfshirë TVSH-në pasi që KCSF përjashtohet nga tarifat e tilla dhe mallrat ose shërbimet duhet të ofrohen me çmime fikse të njësisë.

Kushtet tjera

Ofertat e pranuar pas datës së pranimit të kërkesës të përcaktuar në ftesën për propozime ose të dorëzuara në mënyrë jo të saktë në përputhje me këto udhëzime, mundet që, me diskrecionin e vetëm të KCSF-së, të mos merren parasysh dhe të kthehen mbrapa dhe refuzohen.

Nëse ofertuesit kanë ndonjë pyetje ose kërkesë për informacion shtesë, ato duhet të dorëzohen përmes postës elektronike në emalin e cekur në Ftesën për kuotim të çmimit, me kohë për të mundësuar përgjigjen, deri me datë 25 gusht 2025, ora 11:00.

KCSF rezervon të drejtën për të refuzuar ndonjë ose të gjitha ofertat e pranuar ose kërkesat për shpjegime shtesë nga kjo ftesë për kuotim të çmimit.

Asnjë ofertë dhe asnjë pjesë e saj nuk do të konsiderohet se është miratuar, përveç nëse për miratimin e tillë ofertuesi është njoftuar me shkrim nga KCSF.

KCSF rezervon të drejtën për të ndërprerë ose modifikuar këtë ftesë.

Para dhënies së kontratës, KCSF mund të kërkojë nga ofertuesit që të ofrojnë informata shtesë për të ndihmuar procesin e vlerësimit.